



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI KUJDESIT SHËNDETËSOR

**Kodi i lëndës: INF 180**  
**Lënda: Shëndet Publik**

PROGRAMI I LËNDËS									
Shëndet Publik									
<b>Titullari i lëndës:</b>		<b>Vitori Hasanaj</b> Prof. Asoc. PhD në Shkencat e Shëndetit Publik _____							
<b>Ngarkesa:</b>	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	8 ECTS	45	28	0	0	2	75	125	200
<b>Tipologjia e lëndës</b>		Lëndë bazë							
<b>Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda</b>		Viti I, Semestri I							
<b>Lloji i lëndës</b>		E detyruar							
<b>Programi i studimit</b>		Bachelor në "Infermieri Mami"							
<b>Kodi i lëndës</b>		INF 180							
<b>Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës</b>		<a href="mailto:vitori.hasani@univlora.edu.al">vitori.hasani@univlora.edu.al</a>							

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuri në fushën e Shëndetit Publik, Shëndetit Mjedisor dhe Kërkimit shkencor në Infermieristikë.</p> <p>Shëndeti Publik: Ky modul studion adresimin e çështjeve të tilla si rritja apo ulja e sëmundjeve të ndryshme në periudha të ndryshme kohore, në popullata të ndryshme, si dhe në subjekte të ndryshme brenda të njëjtës popullatë.</p> <p>Metodologjia e kërkimit shkencor në Infermieri: Në këtë modul trajtohen teknikat dhe metodat bazë me të cilat operohet në fushën e kërkimit shkencor dhe specifikat e studimeve shkencore infermierore.</p> <p>Shëndeti mjedisor: Trajton kryesisht një grup problemesh që lidhen me mjedisin (ajri, uji, toka), kontrolli i sëmundjeve infektive, edukimi shëndetësor si dhe organizimi i shërbimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.</p>
<b>Objektivat e lëndës</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Njohja me konceptet bazë dhe problemet kryesore të shëndetit publik</li><li>▪ Njohja me konceptet bazë dhe problemet kryesore të shëndetit mjedisor</li><li>▪ Njohja me kërkimin shkencor në infermieri dhe rëndësinë e tij në fushën e infermierisë, shëndetit publik dhe mjedisor</li></ul>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>☞ Të identifikojë problemet e shëndetit publik.</li><li>☞ Të identifikojë problemet e shëndetit mjedisor.</li><li>☞ Të realizojë një projekt të detajuar kërkimor shkencor në fushën e shëndetit publik dhe infermierisë</li></ul>



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI KUJDESIT SHËNDETËSOR**

**KONCEPTET THEMELORE**

1. Koncepte bazë mbi shëndetin publik.
2. Sëmundjet që prekin shëndetin publik, nivelet e parandalimit dhe sfidat në të ardhmen.
3. Konceptet bazë mbi kërkimin shkencor.
4. Etapat, llojet e kërkimit shkencor dhe aplikimi i tij në praktikë.
5. Koncepte bazë mbi shëndetin mjedisor.
6. Kushtet për një mjedis të pastër dhe parandalimi i ndotjes.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<b>Kapitulli I: Shëndeti Publik</b> <b>Tema 1</b> - Hyrje në shëndetin publik. Koncepte mbi shëndetin. <i>Njohja me konceptin shëndet, dimensionet dhe modelet e tij.</i> <b>Tema 2</b> - Faktorët përcaktues të shëndetit. <i>Njohja me faktorët përcaktues të shëndetit.</i> <b>Tema 3</b> - Sistemi shëndetësor në Shqipëri. <i>Njohja me sistemin shëndetësor në Shqipëri.</i> <b>Seminar</b> në auditor	<sup>1</sup> <i>fq</i> 5-18 <sup>1</sup> <i>fq</i> 19-27 <sup>1</sup> <i>fq</i> 88-99	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Seminar 1 orë
	<b>Tema 4</b> - Institucionet shëndetësore, detyrat e tyre. <i>Njohja me institucionet shëndetësore dhe detyrat e tyre.</i> <b>Tema 5</b> - Organet dhe institucionet parandaluese. <i>Njohja me institucionet parandaluese.</i> <b>Tema 6</b> - Strukturat e shërbimit shëndetësor në infermieri. <i>Njohja me strukturat e shërbimit shëndetësor në infermieri.</i> <b>Seminar</b> në auditor	<sup>1</sup> <i>fq</i> 89-93 <sup>1</sup> <i>fq</i> 101-110 <sup>1</sup> <i>fq</i> 111-115	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Seminar 1 orë
III.	<b>Tema 7</b> - Shëndeti riprodhues. Detyrat e qendrës së planifikimit familjar. <i>Njohja me qendrën e planifikimit familjar dhe detyrat e infermieres.</i> <b>Tema 8</b> - Llojet e parandalimit në shëndetin publik. <i>Njohja me nivelet e parandalimit të sëmundjeve në shëndetin publik.</i> <b>Tema 9</b> - Promocioni shëndetësor. Edukimi dhe promocioni shëndetësor. <i>Njohja me edukimin, promocionin, mjediset dhe audiencën për edukim dhe promocion shëndetësor.</i> <b>Seminar</b> në auditor	<sup>1</sup> <i>fq</i> 101-107 <sup>1</sup> <i>fq</i> 51-65 <sup>1</sup> <i>fq</i> 116-149	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Seminar 1 orë
	<b>Tema 10</b> - Modele dhe përjasje në promocionin shëndetësor. <i>Njohja me modelet dhe përjasjet e promocioni shëndetësor.</i> <b>Tema 11</b> - Promocioni nëpërmjet Mas – Medias. Promocioni shëndetësor në shkolla. <i>Njohja me përdorimin e Mas-medias për promocion, si dhe promocionin shëndetësor në shkolla.</i> <b>Tema 12</b> - Promocioni shëndetësor në shërbimet spitalore dhe parësor <i>Njohja me promocionin shëndetësor në spitale dhe shërbimin shëndetësor parësor.</i> <b>Seminar</b> në auditor	<sup>1</sup> <i>fq</i> 150-165 <sup>1</sup> <i>fq</i> 166-178;188-199 <sup>1</sup> <i>fq</i> 200-210	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Seminar 1 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
V.	<p><b>Tema 13</b> - Promocioni shëndetësor në vendin e punës. Shërbimi shëndetësor në ndërmartje.  <i>Njohja me promocionin shëndetësor në vendin e punës.</i></p> <p><b>Tema 14</b> - Shëndeti dhe stili i jetës.  <i>Njohja me promovimin e shëndetit dhe një stili jetese të shëndetshëm.</i></p> <p><b>Tema 15</b> - Duhani, ndikimi mbi shëndet. Parandalimi.  <i>Njohja me grupet e riskut ndaj duhanpirjes, pasojat e tij mbi shëndetin dhe mënyrat e kontrollit dhe parandalimit të konsumit të tij.</i></p> <p><b>Seminar</b> në auditor</p>	<p><sup>1</sup>fq 179-187</p> <p><sup>1</sup>fq 211-224</p> <p><sup>1</sup>fq 225-231</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p>
VI.	<p><b>Tema 16</b> - Alkooli, ndikimi mbi shëndet. Parandalimi.  <i>Njohja me grupet e riskut ndaj alkoolit, pasojat e tij mbi shëndetin dhe mënyrat e kontrollit dhe parandalimit të konsumit të tij.</i></p> <p><b>Tema 17</b> - Droga, ndikimi mbi shëndet. Parandalimi.  <i>Njohja me grupet e riskut ndaj drogës, pasojat e saj mbi shëndetin dhe mënyrat e kontrollit dhe parandalimit të konsumit të saj.</i></p> <p><b>Tema 18</b> - Infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe parandalimi i tyre.  <i>Njohja me grupet e riskut ndaj IST-ve, pasojat e mostrajimit të tyre mbi shëndetin dhe mënyrat e kontrollit dhe parandalimit të përhapjes së tyre.</i></p> <p><b>Seminar</b> në auditor</p>	<p><sup>1</sup>fq 231-241</p> <p><sup>1</sup>fq 241-249</p> <p><sup>1</sup>fq 250-262</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p>
VII.	<p><b>Tema 19</b> - Aksidentet rrugore, problem shqetësues i shëndetit.  <i>Njohja me grupet e riskut ndaj aksidenteve rrugore, faktorët e rrezikut dhe mënyrat e kontrollit dhe parandalimit të ndodhjes së tyre.</i></p> <p><b>Tema 20</b> - Promovimi i shëndetit mendor.  <i>Njohja me grupet e riskut ndaj sëmundjeve mendore, faktorët e rrezikut dhe mënyrat e promovimit të shëndetit mendor dhe parandalimit të çrregullimeve mendore.</i></p> <p><b>Tema 21</b> - Hyrje në epidemiologji. Konceptet bazë epidemiologjike mbi sëmundjet.  <i>Njohja me epidemiologjinë dhe konceptet e saj bazë.</i></p> <p><b>Seminar</b> në auditor</p>	<p><sup>1</sup>fq 263-280</p> <p><sup>1</sup>fq 281-294</p> <p><sup>2</sup> fq 66-87</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p>
VIII.	<p><b>Kapitulli II : Metodologjia e kërkimit shkencor</b></p> <p><b>Tema 22</b> - Koncepte bashkëkohore kërkimore në fushën e infermieristikës.  <i>Njohja me koncepte bashkëkohore kërkimore në fushën e infermieristikës.</i></p> <p><b>Tema 23</b> - Roli dhe e ardhmja e kërkimit shkencor në infermieri dhe shëndetin publik.  <i>Njohja me rolin e kërkimit shkencor në infermieri dhe shëndet publik.</i></p> <p><b>Tema 24</b> - Madhësitë e shpeshtësisë së sëmundjes dhe vdekshmërisë. Incidenca. Prevalenca.  <i>Njohja me madhësitë e shpeshtësisë së sëmundjes dhe vdekshmërisë në popullatë.</i></p> <p><b>Seminar</b> në auditor</p>	<p><sup>3</sup>fq 3-6</p> <p><sup>3</sup>fq7-17</p> <p><sup>3</sup>fq 41-47</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
IX.	<b>Tema 25</b> - Klasifikimi i studimeve epidemiologjike. Studimet kohort, rast-kontroll dhe transversale. <i>Njohja me klasifikimin e studimeve epidemiologjike.</i>	<sup>3</sup> fq 18-25	Leksion 1 orë
	<b>Tema 26</b> - Programet depistuese. Kriteret e një programi të mirë depistues, efektet e mundshme anësore të një programi depistues. <i>Njohja me programet depistuese dhe kriteret e tyre.</i>	<sup>3</sup> fq48-50	Leksion 1 orë
	<b>Tema 27</b> - Sensitiviteti, specifikiteti. Vlera parashikuese pozitive dhe vlera parashikuese negative. <i>Njohja me madhësitë e e evidentimit të subjekteve të sëmurë dhe jo të sëmurë në popullatë.</i>	<sup>3</sup> fq50-52	Leksion 1 orë
	<b>Seminar</b> në auditor		Seminar 1 orë
X.	<b>Tema 28</b> - Studimet kualitative dhe kuantitative. Dallimet midis tyre. <i>Njohja me studimet cilësore dhe sasiore, si dhe dallimet midis tyre.</i>	<sup>4</sup> fq 25-31	Leksion 1 orë
	<b>Tema 29</b> - Formulimi i qëllimit dhe objektivave të studimit. <i>Njohja me formulimin e qëllimit dhe objektivave të studimit.</i>	<sup>3</sup> fq 25-31	Leksion 1 orë
	<b>Tema 30</b> - Përzgjedhja e popullatës, rasteve dhe kontrolleve. <i>Njohja me kriteret e përzgjedhjes së popullatës, mostrës, rasteve dhe kontrolleve.</i>	<sup>3</sup> fq 25-31	Leksion 1 orë
	<b>Seminar</b> në auditor		Seminar 1 orë
XI.	<b>Tema 31</b> - Hartimi i pyetësorëve. Përdorimi i burimeve dokumentare. <i>Njohja me rregullat e hartimit të një pyetësori dhe përdorimin e burimeve dokumentare.</i>	<sup>3</sup> fq 32-40	Leksion 1 orë
	<b>Tema 32</b> - Mbledhja, analizimi dhe interpretimi i të dhënave. <i>Njohja me mënyrat e mbledhjes, analizimit dhe interpretimit të të dhënave.</i>	<sup>3</sup> fq 145-171	Leksion 1 orë
	<b>Tema 33</b> - Shkrimi i review (studimi i literaturës) dhe referimi i burimit bibliografik. <i>Njohja me shkrimin e një review dhe referimin e burimit të informacionit në bibliografi.</i>	<sup>3</sup> fq 40-52	Leksion 1 orë
	<b>Seminar</b> në auditor		Seminar 1 orë
XII.	<b>Tema 34</b> - Shkrimi i studimeve rast-raport. <i>Njohja me hapat e shkrimit të një rast- raporti.</i>	<sup>f</sup> q 53-60	Leksion 1 orë
	<b>Tema 35</b> - Shkrimi i studimeve klinike dhe komunitare. <i>Njohja me shkrimin e studimeve klinike dhe komunitare.</i>		Leksion 1 orë
	<b>Tema 36</b> - Shkrimi i temës së diplomës. <i>Njohja me hapat dhe rregullat e shkrimit të një teze diplome.</i>		Leksion 1 orë
	<b>Seminar</b> në auditor		Seminar 1 orë
XIII.	<b>Kapitulli III : Shëndeti Mjedisor</b>		
	<b>Tema 37</b> - Faktorët e mjedisit. Impakti mbi shëndetin. <i>Njohja me faktorët mjedisorë dhe ndikimin e tyre në shëndet.</i>	<sup>6</sup> fq 3-9	Leksion 1 orë
	<b>Tema 38 - 39</b> - Higjena e mjedisit ajror. Vetitë, ndotja dhe parandalimi i ndotjes. <i>Njohja me vetitë higjenske të ajrit dhe parandalimin e ndotjes së tij.</i>	<sup>6</sup> fq 9-19	Leksion 1 orë
			Leksion 1 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<b>Seminar</b> në auditor		Seminar 1 orë
XIV.	<b>Tema 40</b> - Higjena e ujit. Rëndësia fiziologjike dhe higjenike. Ndotja dhe vetitë bakteriologjike. <i>Njohja me kushtet higjenike të ujit.</i>	<sup>6</sup> fq19-28	Leksion 1 orë
	<b>Tema 41</b> - Sistemi i furnizimit të ujit të pijshëm. Ndërtimi i ujësjellësit. Metodatat e përpunimit dhe monitorimi të ujit. <i>Njohja me furnizimin e ujit të pijshëm dhe metodatat e përpunimit dhe monitorimit të tij.</i>	<sup>6</sup> fq 28-29	Leksion 1 orë
	<b>Tema 42</b> - Toka dhe shëndeti. Ngrohja dhe ndriçimi i mjediseve të banuara. <i>Njohja me vetitë higjenike të tokës dhe parandalimin e ndotjes së saj.</i>	<sup>6</sup> fq 29 - 34	Leksion 1 orë
	<b>Seminar</b> në auditor		Seminar 1 orë
XV.	<b>Tema 43</b> - Higjena e institucioneve shëndetësore. <i>Njohja me vetitë higjenike të institucioneve shëndetësore.</i>	<sup>6</sup> fq 34-44	Leksion 1 orë
	<b>Tema 44</b> - Ligji mbi inspektoriatin sanitar. <i>Njohja me ligjin mbi inspektoriatin sanitar.</i>	<sup>7</sup> referenca 4	Leksion 1 orë
	<b>Tema 45</b> - Komponentët përbërës të racionit ushqimor dhe rëndësia mbi shëndetin. Bazat e konservimit të ushqimeve. <i>Njohja me komponentët përbërës të racionit ushqimor, rëndësinë e tyre mbi shëndetin dhe bazat e konservimit.</i>	<sup>6</sup> fq 44 - 50	Leksion 1 orë
	<b>Seminar</b> në auditor		Seminar 1 orë

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE						
<b>FREKUENTIMI:</b>	Kyçi i një edukimi të suksesshem është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e seminarit janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrëveshje me pedagogun. Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.					
<b>KONTROLLI I VAZHDUESHËM</b>	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi I	Java 7/8	Kapitulli I = Leksion nr 1,2,3 dhe 4.	30 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Provimi përfundimtar	Fundi i semestrit	Kapitulli II	60 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Gjatë semestrit	-	10 pikë	Pyetje me gojë/shkrim	-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI KUJDESIT SHËNDETËSOR

	<i>*Vlerësim i vazhduar</i> - Do të realizohet prej pedagogut të seminarit për gjatë gjithë semestrit. Studenti vlerësohet mbi aftësinë për të përpunuar materialin e dhënë, krijimin e lidhjeve logjike rreth temave, interesin për punë kërkimore rreth atij materiali dhe aftësinë për të krijuar lidhje mes aspektit teorik dhe praktik të lëndës.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
5	6	7	8	9	10	

LITERATURA	
<b>Literatura bazë</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. <b>‘Shëndet Publik’</b> G. Qirjako, G. Burazeri, E. Roshi, V. Hasani 2010 (Fakulteti i Mjekësisë - UV)</li><li>2. <b>‘Shëndeti mjedisor’</b>, cikël leksionesh 2013, E. Kijaj.</li><li>3. <b>‘Metodologjia e kërkimit shkencor’</b> G. Burazeri, E. Roshi, 2010 (Fakulteti i Mjekësisë - UV)</li></ol>
<b>Literatura e rekomanduar</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>o ‘Epidemiologjia’ E. Roshi, G. Burazeri, 2010 (Fakulteti i Mjekësisë - UV)</li><li>o ‘Shëndet Publik’ E. Roshi, G. Burazeri 2006 (Fakulteti i Mjekësisë - UV)</li><li>o ‘Hyrje në kërkimin shkencor në infermier’, cikël leksionesh 2016, B. Subashi.</li><li>o <a href="http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/ligjet/Per-inspektoriatin-sanitar-shteteror.pdf">http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/ligjet/Per-inspektoriatin-sanitar-shteteror.pdf</a> Key Concepts in Public Health (SAGE Key Concepts series) Frances Wilson Andi Mabhala 2008</li><li>o “Foundations for Health Promotion (Public Health and Health Promotion)” Jennie Naidoo BSc MSc PGDip PGCE, JaneWills BA MA MSc PGCE Professor 2009</li><li>o “Metodología de la investigación” Edelsys Hernández Meléndrez. Escuela Nacional de Salud Pública 2006, <a href="http://biblioteca.ucv.cl/site/servicios/documentos/como_escribir_tesis.pdf">http://biblioteca.ucv.cl/site/servicios/documentos/como_escribir_tesis.pdf</a></li><li>o “Metodología de la Investigación”, <a href="http://www.aniorte-nic.net/progr_asignat_met_investigac4.htm">http://www.aniorte-nic.net/progr_asignat_met_investigac4.htm</a></li></ul>

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
<b>Dispozita:</b>	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
<b>Vonesat</b>	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
<b>Sjellja profesionale e studentit</b>	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI KUJDESIT SHËNDETËSOR**

	<p>Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik.</p>
<b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b>	<p>Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnje burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.</p>